

PROJEKT MARREVESHJE BASHKIMI ME PERTHITHJE

Ky Projekt Marreveshje Bashkimi me Perthithje (me poshte referuar si "**Marreveshja**"), me date 6/4/2013 eshte lidhur ndermjet:

LIMJON PESKA SH.P.K., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar ne menyre te rregullt dhe ekzistuese sipas legjislacionit Shqiptar, me seli ne Rruga Nacionale Sarande-Tirane, Km-4, Godine 1-kateshe, Perballe Repartit Ushtarak, Vrion, Vlore, Shqiperi, rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit me Numer Unik Identifikimi (NIPT) J64103863R ("**Shoqeria e Perthithur**");

dhe

ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE SH.A., nje shoqeri aksionare e themeluar ne menyre te rregullt dhe ekzistuese sipas legjislacionit Shqiptar, me seli ne Rruga Nacionale Sarande-Tirane, Km-4, Godine 1-kateshe, Perballe Repartit Ushtarak, Vrion, Vlore, Shqiperi, rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit me Numer Unik Identifikimi (NIPT) K83729804R ("**Shoqeria Perthithese**")

Shoqeria e Perthithur dhe Shoqeria Perthithese referohen me poshte se bashku si "**Palet**" ose secila me vete si "**Pale**".

DUKE QENE SE, Andromeda Aquacultures International B.V. nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Amsterdam, me adrese ne Koningslaan 17, 1075 AA Amsterdam, Hollande, rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar te Dhomes Tregtare Hollandeze te Amsterdamit me numer rregjistrimi: 33221565, eshte ortaku i vetem i Shoqerise se Perthithur, duke zoteruar 100 (nje qind) kuota ne Shoqerine e Perthithur me nje vlere nominale prej 435 876.84 Lek (katerqind e tridhjetete e pese mije e teteqind e shtatedhjetete e gjashte pike tetedhjetete e kater Leke) secila, qe perbejne 100% (nje qind perqind) te kapitalit te rregjistruar te Shoqerise se Perthithur

DUKE QENE SE, Andromeda Aquacultures International B.V. dhe **Z. Ahilea Papuci** jane aksioneret e Shoqerise Perthithese ku (i) **Andromeda Aquacultures International B.V.** zoteron 3,218,420 (tre milione e dyqind e tetembedhjetete mije e katerqind e njetete) aksione ne Shoqerine Perthithese me nje vlere nominale prej 100 Leke (nje qind Leke) secila, qe perbejne 99.84% (nentedhjetete e nente pike tetedhjetete e kater perqind) te kapitalit te rregjistruar te Shoqerise Perthithese dhe (ii) **Z. Ahilea Papuci** zoteron 4,980 (kater mije e nenteqind e tetedhjetete e kater) aksione ne Shoqerine Perthithese me nje vlere nominale prej 100 Leke (nje qind Leke) secila, qe perbejne 0.16% (zero pike gjashtembedhjetete perqind) te kapitalit te rregjistruar te Shoqerise Perthithese.

DUKE QENE SE, Palet ne kete Marreveshje deshirojne qe nepermjet kesaj marreveshje te transferojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise se Perthithur tek Shoqeria Perthithese

SI PASQJE, Palet ne kete Marreveshje bien dakort si vijon.



**ANDROMEDA MARINE
AQUACULTURE Sh.a.**
Vat No. K83729804R
Worë, Finaq, Rruga nacionale SARANDE-TIRANE
Zona Industriale, km 4

1. BASHKIMI

1.1 Kjo Marreveshje rregullon bashkimin e Shoqerise se Perthithur tek Shoqeria Perthithese

1.2 Ne perputhje me Nenin 215(1) te Ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (the "Ligji per Shoqerite Tregtare"), Shoqeria e Perthithur nepermjet kesaj Marreveshje transferon te gjitha asetet dhe detyrimet e saja tek Shoqeria Perthithese.

1.3 Bashkimi behet ne baze te pasqyrave financiare te Shoqerise se Perthithur dhe Shoqerise Perthithese te mbyllura me 31.12.2012 te cilat i jane bashkangjitur kesaj marreveshjeje dhe jane pjese integrale e saj.

1.4 Shoqeria e Perthithur dhe Shoqeria Perthithese nepermjet kesaj Marreveshje bien dakord qe te bejne bashkimin e asetëve dhe detyrimeve tek Shoqeria Perthithese ne kembim te numrit te aksioneve qe Palet do te marrin ne Shoqerine Perthithese dhe ne perputhje me raportin e kembimit te aksioneve te percaktuar ne seksionin 1.5 me poshte.


1.5 Palet nepermjet kesaj Marreveshje bien dakord qe te vendosin nje raport shkembimi prej 48.379,7 (dyzet e tete mije e treqind e shtatedhete e nente presje shtate) aksione ne Shoqerine Perthithese per cdo kuote te Shoqerise se Perthithur perpara bashkimit. Palet nepermjet kesaj Marreveshje bien dakord qe te vendosin nje raport shkembimi prej 1 (nje) aksion ne Shoqerine Perthithese per cdo aksion te Shoqerise Perthithese perpara bashkimit. Palet nuk parashikojne ndonje konsiderate ne te holla midis tyre.

1.6 Ne perputhje me bashkimin, Shoqeria Perthithese do te ndryshoje strukturen aksionare ne menyre qe te reflektoje bashkimin e Shoqerise se Perthithur tek Shoqeria Perthithese nga ku **Andromeda Aquacultures International B.V.** do te zoteroje 8.056 210 aksione me nje vlere nominale prej 9.93 leke secila qe perben 99,94% te kapitalit te rregjistruar te Shoqerise Perthithese dhe **Z. Ahilea Papuçi** do te zoteroje 5.157 aksione me nje vlere nominale prej 9,93 leke secila qe perben 0,06% te kapitalit te rregjistruar te Shoqerise Perthithese. Pra, ne perfundim te bashkimit me perthithje kapitali i Shoqerise Perthithese do te jete ne vleren 8.049.374 Leke.

1.7 Te gjitha aksionet ne Shoqerine Perthithese ne daten qe mban kjo Marreveshje do te zoterohen nga Andromeda Aquacultures International B.V. dhe Z. Ahelia Papuçi sic percaktohet ne seksionin 1.6 me larte dhe te gjithë keto aksione do te jene aksione te zakonshme qe u japin aksionereve te Shoqerise Perthithese te drejta te njejta

1.8 Si pasoje e bashkimit te Shoqerise se Perthithur tek Shoqeria Perthithese, Shoqeria e Perthithur do te priset dhe c'rregjistrohet nga rregjistrari tregtar i mbajtur nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit.

1.9 Shoqeria Perthithese dhe Shoqeria e Perthithur caktojne Z. Vasillaq Larushi ne cilesine e ekspertit kontabel te autorizuar per te vleresuar kushtet e kesaj projekt-marreveshje bashkimi me perthithje.



2. EMRI I SHOQERISE PERTHITHESE, SELIA DHE ANETARET E KESHILLIT TË ADMINISTRIMIT

2.1 Emri i Shoqerise Perthithese, si dhe selia e saj do te mbeten te pandryshuara. Anetaret e Keshillit te Administrimit dhe Keshillit Mbikqyres te Shoqerise Perthithese dhe perfaqesuesit ligjor do te mbeten te pandryshuar

3. MBROJTJA E KREDITOREVE

3.1 Shoqeria Perthithese do te ofroje garanci te mjaftueshme te gjithe kreditoreve te seciles prej Paleve te cilet e kerkojne kete garanci brenda 6 muajve nga data e publikimit te regjistrimit te marreveshjes se bashkimit, sipas kushteve te parashikuara ne Nenin 221 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.

4. MARREDHENIET E PUNES

4.1 Te gjithe te drejtat dhe detyrimet qe lindin nga kontratat e punes te lidhura nga Shoqeria e Perthithur do te transferohen tek Shoqeria Perthithese nga ku te gjithe punemarresit do te vendosen ne pozicione pune ne perputhje me rregullat e brendeshme te Shoqerise Perthithese dhe Ligjit Nr. 7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punes se Republikes se Shqiperise".

5. DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

5.1 Secila Pale do te mbuloje shpenzimet e veta lidhur me shpenzimet e keshillimeve ligjore, financiare dhe tatimore.

5.2 Modifikimet dhe ndryshimet ne Marreveshje do te jene te vlefshme vetem nese jane bere ne forme te shkruar.


5.3 Kjo Marreveshje do te qeveriset nga dhe interpretohet e zbatohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

5.4 Cdo mosmarreveshje qe lind ne baze te ose ne lidhje me kete Marreveshje do te zgjidhet nga nje gjykate kompetente ne Tirane.

5.5 Kjo Marreveshje eshte lidhur ne gjuhen Angleze dhe me pas eshte perkthyer ne gjuhen Shqipe. Gjuha Angleze do te jete gjuha e detyrueshme dhe mbizoteruese per te gjitha ceshtjet lidhur me perkufizimin ose interpretimin e kesaj Marreveshje.

5.6 Pavlefshmeria dhe pazbatuesmeria e ndonje prej dispozitave te kesaj Marreveshje nuk do te ndikojne ne vlefshmerine dhe zbatuesmerine e dispozitave te tjera te kesaj Marreveshjeje. Cdo dispozite e pavlefshme dhe e pazbatueshme do te zvendesohet nga nje dispozite e vlefshme dhe e zbatueshme ne nje menyre qe kjo dispozita e re te reflektojte sa me shume efektet ligjore dhe ekonomike qe Palet pretendonin te arrinin nepermjet dispozites se pavlefshme dhe, te pazbatueshme.

5.7 Kjo Marreveshje eshte pergatitur ne 5 kopje.



ANDROMEDA MARINE
AQUACULTURE Sh.a.
Vat No. K83729804R
Vlorë, Finiq, Rruga nacionale SABANË - TIRANË
Zona Industriale, km 4

NE EMER TE: LIMJON PESKA SH.P.K.

ELTON HUSA
Z. Elton Hysa




KARVELAS IOANNIS
Z. Ioannis Karvelas



NE EMER TE: ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE SH.A.

ELTON HUSA
Z. Elton Hysa




KARVELAS IOANNIS
Z. Ioannis Karvelas



**RAPORT
I EKSPERTIT PER BASHKIMIN E SHOQERIVE**

**MBI OPERACIONIN E BASHKIMIT NEPERMJET PERTHITHJES SE SHOQERISE
"LIMJON PESKA,, sh.pk, NGA SHOQERIA "ANDROMEDA MARINE
AQUACULTURE,, sh.a.**

Une **Vasillaq Larushi** Ekspert kontabel i autorizuar me numer license profesionale Lic Nr.293 dt.27.08.2012, anetar i Insituitit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, bazuar ne kerkesat individuale te pertagesuesve te shoqerive "Andromeda Marine Aquaculture,, sh.a dhe "Limjon Peska,, shpk jam cakmuar te kryej misionin e ekspertit te bashkimit me perthithje te shoqerive te sipercituara.

Misioni i ngarkuar eshte i perbashket per te gjitha shoqerite qe marin pjese ne bashkim me ane te perthithjes.

I. Informacion mbi shoqerite dhe kushtet financiare te operacionit te bashkimit te hartuara dhe te pranuar nga shoqerite pjesmarrese.

Drejtimi i shoqerive "Andromeda Marine Aquaculture,, sh.a dhe "Limjon Peska,, shpk kane hartuar sebashku projektin e bashkimit me perthithje te 2 shoqerive, duke hartuar termat perfundimtare te projektit, si metoden e vleresimit, drejtimin e bashkimit, raportet e kembimit, aktivet dhe pasivet qe do te transferohen.

Sipas projektit te bashkimit, shoqerite pjesmarrese, motivet, qellimet, modalitetet dhe kushtet e bashkimit paraqiten si vijon:

Shoqerite pjesmarrese ne'operacionin e bashkimit kane te dhenat e meposhteme:

Shoqeria perthithese:

"Andromeda Marine Aquaculture ,, sh.a eshte regjistruar me 29/01/2008 prane QKR Tirane, me NIPIT K83729804R. Selia e shoqerise eshte Rruga Nacionale Sarande Tirane, zona industriale, km.4, godine 1 kateshe, perballe repartit ushtarak, Fiqiq, Vriion
Kapitali i saj eshte 322.340.000 leke, i ndate ne 3.223.400 aksione me vlere nominale 100 leke/aksion dhe zoterohet nga aksioneret:

- Andromeda Aquacultures International B.V 99,84 % te kapitalit aksionar ose 3.218.420 aksione.



- Ahila Papuçi me 0.16 % të kapitalit akcionar ose 4.980 aksione.

Shoqeria e perthithur:

“Limjon peska,, shpk është themeluar me Vendimin e Gjykeses së rrethit Tirane nr. 27852 date 21.05.2002, me NIPIT J64103863R.

Selia e shoqerise është ne Rruga Nacionale Sarande-Tirane,Km-4,Godine 1-kateshe, Perballe Repartit Ushtrarak Fëniq, Vrion. Kapitali është 43,587,684 leke, i ndare ne 100 pjese me vlere nominale 435,876.84 leke/kuote dhe zoterohet 100% nga Andromeda Aquacultures International B.V

Ne projektin e bashkimit është projektuar që shoqeria “Andromeda Marine Aquaculture,, sh.a. do të jetë shoqeria perthithese dhe do të shenohet me poshte si shoqeria perfituese, kurse shoqeria “Limjon Peska,,shpk, shoqeri e perthithur që do të shenohen me poshte si shoqeri kontribuese.

Sipas projektit qellimi i bashkimit është grupimi i forcave dhe mjeteve për krijimin e produkteve të reja dhe i marketingut në funksion të rritjes së perfitimeve ekonomike si dhe efektshmerise, menaxhimi me të mire i burimeve njerezore dhe financiare si dhe perballimi i konkurrencës.

Ne kuadrin e këtij operacioni bashkimi, parashikohet që shoqeria “Limjon Peska,, shpk, do të transferoje (kaloje) shoqerise “Andromeda Marine Aquaculture” sh.a. reresine e elementeve të aktivitetit dhe pasivit duke perfshire edhe ato që rezultojne nga operacionet e kryera pas dates 31.12.2012.

Grupet kryesore të këtyre aktiveve dhe pasiveve të shoqerive pjesmarrese në bashkim, janë caktuar e vlerësuar mbi bazën e vlerave kontabel (vlera e mbeshtetur në pasurine) që ato kanë në pasqyrat financiare të mbyllura me 31.12.2012.

Shoqeria “Andromeda Marine Aquaculture” sh.a. do të jetë zoteruese e kontributit të shoqerise “Limjon peska” shpk “ne datën e realizimit perfundimtar të operacionit. Shoqeria “Limjon Peska” shpk gëzon frutet e kontributit duke filluar nga 01.11.2013 me kushtin e realizimit të bashkimit në fjale.

Ne aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarise të kryera prej shoqerise “Limjon Peska” shpk, nga data 01.01.2013 e deri në datën e realizimit të bashkimit do të konsiderohen si të kryera nga shoqeria perthithese “Andromeda Marine Aquaculture” sh.a dhe regjistrimet perkatese kontabel do të merren në librat e saj.

Llogaritë që janë perdorur për të percaktuar kushtet financiare të bashkimit janë hartuar duke ju referuar dates 31.12.2012 si për shoqerine “Andromeda Marine Aquaculture” sh.a ashtu edhe për shoqerine “Limjon Peska” shpk.

Sipas vleresimeve te bera ne baze te vleres neto te kapitaleve te seciles shoqeri qe merr pjese ne bashkim, eshte rrene dakort qe raporti i kembimit te pjeseve te kapitalit te jete sic vijon:

- Cdo 1 (nje) aksion i shoqerise perthithese (pra Andromeda Marine Aquaculture Sh.A) do te konvertohet me nje aksion te shoqerise mbas bashkimit.
- Cdo 1 (nje) aksion i shoqerise qe perthithet (pra Limjon Peska Sh.P.K) do te konvertohet me 48.379,7 (dyzet e tete mije e treqind e shtatedhejte e nente pike shtate) aksione te shoqerise mbas bashkimit.

Pra duke mare parasysh Kapitalat e vera Neto te te dy shoqerive, shoqeria perthithese duhet te emetoje 4 837.967.1717 aksione me vlere me vlere nominale 9,93 leke. Keto aksione do t'ju shperndahen aksionereve te kompanise se perthithur Limjon Peska Sh.P.K.

Ky operacion bashkimit nuk permban as te drejta dhe as ndonje avantazh te vecante.

II. Bazat e opinionit, shqyrtimi dhe vleresimi i informacionit.

Referuar nenit 217 te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" objektivat e misionit te ekspertit te bashkimit, eshte te verifikojte dhe jape opinionin nese :

- vlerat perkatese qe u jane dhene aksioneve te kapitalit te shoqerive qe marrin pjese ne operacionin e bashkimit jane percaktuar duke zbatuar metoda dhe kriteret te pershtateshme dhe a ka pasur veshuresi te vecanta ne vleresimin e tyre.
- raporti i kembimit te aksioneve eshte i drejte dhe i arsyeshem.

Per kryerjen e misionit dhe hartimin e ketij raporti bashkimi, une jam mbeshtetur ne dokumentat e meposhteme:

- Projektin e bashkimit me perthithje te shoqerive "Andromeda Marine Aquaculture" sh.a me shoqerine "Limjon Peska" shpk, te hartuar dhe nenshkruar nga drejtimi i shoqerive pjesmarrese.
- Pasqyrat financiare , te shoqerive pjesmarrese ne bashkim me 31.12.2012.
- Ne dokumentet ligjore te shoqerive, vendim gjykate, akt themelimi, dhe statutin perkates.
- Ne raportin e bashkimit te pergatitur nga administratorët e kompanive.

Bazuar ne sa me siper si dhe ne metodat e njohura per vleresimet e bizneseve dhe ne ate te pranuar ne projektin e bashkimit qe eshte vlera kontabel (ose e bilancit) une kryeva verifikimet qe kam emuar te nevojshme mbi bilancet kontabel te shoqerive dhe dokumentacionin mbeshtetes te tyre, per percaktimin e vleres ekonomike dhe vleren kontabel te kontributeve te seciles shoqeri pjesmarrese ne bashkim.

(Signature) 3

Ne vijim pasqyrohen aktivet, pasivet dhe aktivi neto i shoqerive qe eshte baze e raportit te kombinit.

Per shoqerine perthithese "Andromeda Marine ,, sh.a

a) AKTIVE

- Mjete monetare	1,714,227
- Aktive te tjera afatshkurtra financiare	540,772,423
- Aktive afatshkurtra materiale	61,358,361
- Aktive afatgjata materiale	82,943,966
- Aktivet afatgjata jomateriale	-
Totali i Aktiveve	686,788,977

b) PASIVE

- Huat dhe parapagimet afatshkurtra	654,786,189
- Detyrimet Afatgjata	-
Totali i detyrimeve	654,786,189

Aktivi neto (a-b)

32,002,788

Provizione per humbje te priteshme nuk jane parashikuar.

Vlera kontabele kontributit

32,002,788 leke

Per shoqerine e perthithur:

Shoqeria "LIMJON PESKA" shpk

a) AKTIVE

- Mjete monetare	6,029,277
- Aktive te tjera afatshkurtra financiare	527,243,302
- Aktive afatshkurtra materiale	-
- Aktive afatgjata materiale	27,138,050
- Aktivet afatgjata jomateriale	-
Totali i Aktiveve	560,410,629

b) PASIVE

- Huat dhe parapagimet afatshkurtra	512,377,981
- Detyrimet Afatgjata	0
Totali i detyrimeve	512,377,981

Aktivi neto (a-b)

48,032,648

Provizione per humbje te priteshme nuk jane parashikuar.

Vlera kontabele kontributit

48,032,648

Nga verifikimet rezulton se per te dy shoqerite vlera kontabel e kontributeve eshte bazuar ne bilancet kontabel te dates 31.12.012 e cilat jane hartuar mbi parime te njejta kontabile dhe vleresuar me te njejten metode vleresimi te percaktuar ne projekt.

Per grupet e aktiveve dhe pasiveve mbesheten ne inventare fizike dhe kontabel analitike dhe jane te perputhura me te dhenat sintetike te paraqitura me siper.

Ato do te jene baza e transferimit te pasurise se shoqerive perthithese me hyrjen ne fuqi te bashkimit.

Vleresimi i metodave te perdorura.

Praktika e vleresimit te bizneseve njih shumte metoda midis te cilave mund te permendim, vleresimi duke u nisur nga vlera e pasurise (vlera kontabel, vlera kontabel e korrigjuar, vlera e mundeshme e shitjes etj); vleresimi i nisur nga parashikimet e veprimtarise dhe rezultateve te ardheshme etj. Zgjedhja e seciles prej metodave te mesiperme eshte ne varesi te natyres ekonomike e operacionit dhe eshte e rendesishme qe te zbatohet ne menyre te njejte per te gjitha shoqerite pjesmarrese. Une mendoj se metoda e zgjedhur nga dy shoqerite Vlera kontabel(Vlera e bilancit) i pershtatet natyres se aktiveve qe shoqerite kane ne bilancet e tyre dhe arrihet percaktimi i nje vlere sa me perfqesuese per secilen shoqeri.

Pas verifikimeve dhe shqyrtimeve te kryera informacionin lidhur me operacionin e bashkimit me perthithje po e pasqyroj ne tabelen e meposhteme:

Nr	Shoqerite pie-marrese	Shuma e kapitalit themelitar	Numri i kuotave te kapitalit	Vlera minimale per nje kuote	Vlera e shoqerise nxjerre nga Vlera neto Kontabel	Vlera per njesi e kuotes sipas Vleres Neto
		1=2x3	2	3	4	5=4 / 2
1	Andromeda Marine Aquaculture	322,340,000	3,223,400	100	32,002,788	9,928
2	Limjon Peska	43,587,684	100	43587	48,032,648	110,20

Nga te dhenat e mesiperme rezulton se raportet e kembimit nisur nga vlera e shoqerise nga vleresimet per shoqerine qe perthithet jane:

- Cdo 1 (nje) aksion i shoqerise perthithese (pra Andromeda Marine Aquaculture Sh.A) do te konvertohet me nje aksion te shoqerise mbas bashkimit.
- Cdo, 1(nje) aksion i shoqerise qe perthithet (pra Limjon Peska Sh.P.K) do te konvertohet me 48.379,7 (dyzet e tete mije e treqind e shtatedhejte e nente pike shtate) aksione te shoqerise mbas bashkimit.

III. Konkluzion

Ne perfundim te verifikimeve te kryera konkludoj se:

- Vlerat qe u jane dhene aksioneve ne kapitalin e shoqerive qe marrin pjese ne kete operacion bashkimi me perthithje jane percaktuar duke zbatuar kriteret e pershtateshme.
- Vendimi per bashkimin e shoqerive eshte ne perputhje me ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- Projekti i perdorur per realizimin e bashkimit eshte i rregullt.
- Raporti i kembimit eshte i sakte dhe i drejte.
- Operacioni i bashkimit nuk cenon barazine e aksionereve.

Nese operacioni i bashkimit realizohet sipas projektit te paraqitur, kapitalit te nenshkruar te shoqerise "Andromeda Marine Aquaculture" sh.a prej 322,340,000 leke pasi eshte zvogeluar me humbjet e akumuluar dhe fitimin ushtrimor per vleren (290,337,212) i shtohet edhe kapitali themeltar i shoqerise "Limjon Peska" shpk, si me poshte:

- Kapitali i nenshkruar per shumen 43,587,684 leke
- Fitimi i viti ushtrimor per shumen 4,444,964 leke

Shuma e zvogelimit te kapitalit (314,621,017) leke.

Shuma e kapitalit ne total eshte 80,035,436 leke

Vlera e zmadhimit te kapitalit nga shoqeria perthithese i pergjigjet raporteve te kembimit dhe pasurise qe transferohet.

Para fillimit te procedurave te bashkimit, kapitali themeltar i shoqerise perthithese "Andromeda Marine Aquaculture", sh.a eshte 322,340,000 leke leke i perbere nga 3,223,400 aksione me vlere nominale 100 leke secili akston.

Duke mare per baze vleresimin sipas vleres se Kapitaleve te veta te shoqerise vlere nominale e nje aksioni eshte 9,93 leke. Nisur nga koeficienti i kembimit midis aksioneve te dy shoqerive, shoqeria perthithese duhet te emetoje 4.837.967 aksione me vlere nominale 9,93 leke. Aksione keto qe do tu jepen aksionereve te shoqerise qe perthithet (aksionereve te shoqerise Limjon Peska).

Mbas realizimit te operacionit te bashkimit me perthithje struktura aksionare e Shoqerise Perthithese do te ndryshoje nga ku Andromeda Aquacultures International B.V. do te zoteroje 8.056.210 aksione me nje vlere nominale prej 9,93 leke secila qe perben 99,94% te kapitalit te rregjistruar te Shoqerise

Perthithese dhe Z. Ahilea Papuçi do të zoterojë 5.157 akcione me një vlerë nominale prej 9,93 leke secila që përben 0,06% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë Perthithese. Pra, në përfundim të bashkimit me perthithje kapitali i Shoqërisë Perthithese do të jetë në vlerën 8.049.374 Leke. Përkatesia e këtyre aksioneve është sipas tabelës me poshtë:

		Kuotat sipas vlerës së kapitaleve të veta (9,93lek/kuote)	Kapitali në vlerë/Leke sipas kapitaleve të veta
Andromeda Marine Aquaculture	Perqindjet aktuale	3.223.400	3.223.400
Andromeda BV	99,84%	3.218.243	3.218.243
Ahile Papuci	0,16%	5.157	5.157
Limjon Peska	Perqindjet aktuale	4.837.967	4.837.967
Andromeda BV	100%	4.837.967 ¹	4.837.967
Nga bashkimi	Perqindjet si rrjedhojë e bashkimit		
Andromeda BV	99,94%	8.056.210	79.998.165,3
Ahile Papuci	0,06%	5.157	51.209,01

Tirane, më 6.4.2013

Ekspert kontabel i autorizuar

Vasillaq Larushi

VASILLAQ LARUSHI
EKSPERT KONTABEL 293
NIPT K 72205015 H

Vasillaq Larushi
[Signature]

¹ Kuotat e Kompanisë Limjon Peska sipas regjistrimit në QKR janë 100 kuota që zoterohen 100% nga Andromeda Aquaculture International B.V. Këtu paraqitet numri i kuotave i konvertuar në bazë të raportit të konvertimit të përmendur më lart.